



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E FINANCËS BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 12955 prot.

Vlorë, më 15 .08 2024

PROJEKTVENDIM
Nr. _____, Datë _____.2024

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB NR.100, DT.29.12.2023
PËR BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2024”**

Në bazë të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8, pika 2, 9 pika 1.1 b, 34, 35, 36, 37,40, 41, 54 pika dh, dhe neni 64 pika c , Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 45, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 44 ; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të Menaxhimit të Buxhetit”, Udhëzimi plotësues nr. 2 datë 28.02.2024 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2024”, V.K.B nr.100 datë 29.12.2023 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë për Vitin 2024”. VKB nr. 29 datë 28.03.2024 “Për disa ndryshime ne V.K.B nr. 100 datë 29.12.2023 Miratimin e Buxhetit të Bashkisë për Vitin 2024” si edhe : Vendim nr. 419, datë 26.6.2024 “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” dhe Vendim nr. 425, datë 26.6.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar” dhe shkresës së ardhur nga Ministria e Financës, Drejtoria e Përgjithëshme e Buxhetit, Drejtoria e Financave Vendore me nr. 8098/2 Prot ., datë 25.07.2024 në Bashkinë Vlorë me nr. 11925 Prot ., datë 29.07.2024

VENDOSI:

1. Të miratojë Grantin Specifik të dhënë nga Këshilli i Ministrave për efektin e rritjes së pagave (në 000 lekë):

- | | |
|---|--------|
| • Të ardhura gjithsej | 30.548 |
| a. Fonde nga transfertat specifike për PMNZSH | 3.524 |
| b. Fonde nga transfertat specifike për Arsimin parashkollor | 27.024 |

2. Të miratojë shpenzimet si më poshtë (në 000 lekë):



- Shpenzime gjithsej 30.548

2.1 Shpenzime nga transferta specifike 30.548

- a. Për paga (art.600) 26.160
- b. Për sigurime (art.601) 4.388

3.Shpenzimet e pikës 2.1 do të përdoren sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Nr.	Programi	Emertimi	SHPENZIMET E PLANIFIKUARA NGA FONDET E ARDHURA NGA GRANTI SPECIFIK PER VITIN 2024 PER RRITJEN PAGAVE				
			600	601			Totali
	K03280	PMNZH	3.000	524			3.524
	K09120	Arsimi Parauniversitar	23.160	3.864			27.024
		SHUMA	26.160	4.388			30.548

4.Efektet financiare të rritjes së pagave, pjesërisht do të përballohen nga fondet e përcaktura si më sipër kurse diferencat do të përballohen nga fondet e planifikura dhe të papërdorura nga buxheti i vitit 2024.

5.Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit, autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Këshilli i Bashkisë sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financës.

6.Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015, datë 17.02.2015, neni 55, pika 6.

KRYETAR
Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E FINANCËS BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 12955 prot.

Vlorë, më 15.08.2024

RELACION

Lënda: “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr.100, datë 29.12.2023 për Buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024” për rritjen e pagave të Shërbimit PMNZSH dhe Arsimit Parashkollor.

Drejtuar: KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË

Të nderuar Këshilltarë!

Ligji 9936/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullon sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare ndërqeveritare dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi. Ligji zbatohet nga njësitë e Qeverisjes Qendrore dhe Vendore në të gjitha fazat e procesit buxhetor si përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi në Këshill, zbatimi, ndjekja dhe rishikimi i buxhetit, të drejtat dhe kufizimet që përcakton ligji, garancitë, si dhe format e tjera të rrjedhura prej tyre, kontrolli, kontabiliteti, raportimi, inspektimi dhe auditimi i buxhetit.

Nga sa më lartë, Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe administrata nën drejtimin e tij, kanë hartuar projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr.100, datë 29.12.2023 për Buxhetin e Bashkisë për vitin 2024” në lidhje me rritjen e pagave të Shërbimit PMNZSH dhe Arsimit Parashkollor, bazuar në ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, nenet: 9 pika 1.1.b, 34, 35, 36, 37, 40, 41, 54 pika dh, dhe neni 64 pika c; Ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 45, Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit e Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 44 si edhe Vendim nr. 419, datë 26.6.2024 “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” dhe Vendim nr. 425, datë 26.6.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të Punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar” dhe shkresës së

ardhur nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithëshme e Buxhetit, Drejtoria e Financave Vendore me Nr. 8098/2 Prot., datë 25.07.2024 bërë hyrje në Bashkinë Vlorë me Nr.11925 Prot., datë 29.07.2024.

Kërkojmë nga ju:

1. Të miratohet Granti Specifik i dhënë nga Këshilli i Ministrave për efektin e rritjes së pagave (në 000 lekë):

- **Të ardhura gjithsej:** **30.548**
 - a. Fonde nga transferta specifike për PMNZSH 3.524
 - b. Fonde nga transferta specifike për Arsimin parashkollor 27.024

2. Të miratohen shpenzimet si më poshtë (në 000 lekë):

- **Shpenzime gjithsej:** **30.548**
 - 2.1 Shpenzime nga transferta specifike** **30.548**
 - a. Për paga (art.600) 26.160
 - b. Për sigurime (art.601) 4.388

2. Efektet financiare të rritjes së pagave, pjesërisht do të përballohen nga fondet e përcaktura si më sipër, ndërsa diferencat do të përballohen nga fondet e planifikura dhe të papërdorura të buxhetit të vitit 2024.

Të nderuar këshilltarë, Kryetari i Bashkisë dhe administrata e tij, pas shqyrtimit të këtij relacioni ju fton ta miratoni atë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



KRYETAR

Ermal Dredha